



A.nr.86/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.86/2026, të datës 27.01.2026, të parashtruar nga ankuesja F.H-H, nga Vushtrria, në çështjen juridike – administrative “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 30.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar*** ankesa më numër A.nr.86/2026, e datës 27.01.2026, e parashtruar nga ankuesja F.H-H. ***Shfuqizohet*** Vendimi me numër protokolli 00247/26, i datës 05.01.2026, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Vushtrrisë, ndërsa, ***çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje*** të mbikëqyrësi i ankuesit në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë.
- II. *Obligohet*** Udhëheqësi i Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të vendimit, të rishqyrtoj çështjen disiplinore të ankueses duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetim të vendimit.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesja F.H-H (*tutje referuar ankuesja*), më datë 27.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 00247/26, të datës 05.01.2026, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Vushtrrisë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në vijim vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 416/2026 të datës 27.01.2026 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuses; Vendimin me numër protokollit 00247/26, të datës 05.01.2026, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Vushtrrisë; Emailin e datës 24.10.2025 nga Keptarit i SPAK-dega Vushtri për H.U dhe B.D; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 11.02.2026; Vendimin e datës 06.11.2023 për Themelimin e Komisionit Disiplinor; Akt Emërimit e datës 01.08.2024 të ankuses; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile datës 12.02.2018; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 24.10.2025; Emailin e datës 21.10.2025 nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës për L.K; Emailin e datës 21.10.2025 nga L.K për H.U; Kërkesën për deklaratë me shkrim e datës 21.10.2025 nga L.K për ankuesen; Vendimin e datës 05.12.2025 të Komisionit Disiplinor për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurës disiplinore; Dëshminë e pranimi të vendimit për shtyrje nga ankuesja datë 05.12.2025; Njoftimin e datës 27.10.2025 nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor për ankuesen; Ftesë e datës 11.11.2025 për seancë të Komisionit Disiplinor për ankuesen dhe iniciuesin e procedurës disiplinore; Ftesë e datës 14.11.2025 për dëshmitarët A.M-M, F.A; Deklaratën e datës 23.12.2025 nga V.M-Z; Deklaratën e A.T; Deklaratën e Xh.M; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 13.11.2025, 17.11.2025, 30.12.2025, Emailin e datës 23.12.2025 dhe 26.12.2025 nga J.S për A.T, Xh.M, V.M, Sh.U; Ftesë e datës 19.12.2025 nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor për dëshmitarët A.T, Sh.U, V.M-Z, Xh.M; Kërkesën e ankuses e datës 14.11.2025 për anëtarin e komisionit disiplinor për ftesë për dëshmitarët; Komunikimin me telefon 26.12.2025; Vendim për pushim vjetor i datës për Kryesuesin e Komisionit Disiplinor; Raporti i prezencës në punës për periudhën 02.12.2025 deri 24.12.2025 për anëtarin e Komisionit Disiplinor H.A; Emailin e datës 27.10.2025 nga J.S për L.L; Emailin e datës 28.10.2025 nga L.L për J.S; CD e pamjes së kamerave.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe së çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton se:

- Ankuesja është e punësuar në Komunën e Vushtrrisë dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 37428/24, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën Zyrtare për Gjendje Civile, Sektori i Gjendjes Civile.

-Udhëheqësi i Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë, më datë 24.10.2025, përmes parashtrësës më numër të protokollit 56158/25, ka parashtruar kërkesë për iniciim të procedurës disiplinore ndaj ankuses, me arsyetimin se bazuar në kërkesën e Drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës, kam kërkuar deklaratë nga ankuesja më datë 21.01.2025 lidhur me rastin e ndodhur me palën më datë 20.10.2025, mirëpo, e njëjta nuk ka ofruar deklaratë, andaj, këto veprime përbëjnë shkelje të detyrave të punës mos zbatimit të urdhrit të mbikëqyrësit.

- Komisioni Disiplinor i Komunës së Vushtrrisë, më Vendimin me numër protokolli 61781/25, të datës 05.12.2025, ka shtyre afatin për përfundimin e procedurës disiplinore për 30 ditë kalendarike nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- Komisioni Disiplinor i Komunës së Vushtrrisë, më datë 05.01.2026, ka nxjerr Vendim me numër protokolli 00247/26, më të cilin ankuesen e ka bërë përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.7 dhe nenit 29 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*Ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë prej dy (2) viteve*”.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli 00247/26, të datës 05.01.2026, të Komisionit Disiplinor i Komunës së Vushtrrisë, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr jashtë afatit ligjor dhe nuk ka qenë e nevojshme shtyrja e afatit sepse dispozita ligjore për vendosje është imperative dhe e njëjta është dashur të respektohet. Ngas vetë arsyetimi i vendimit të kontestuar rezulton se më datë 20.10.2025, vetë pala ankuese ka qenë e sulmuar nga qytetarja dhe këtë e dëshmojnë të gjithë dëshmitarët që janë ftuar nga komisioni disiplinor çoftë me ftesën e tyre çoftë me propozimin tim, dhe përkundër kësaj ky komision nuk ka marr parasysh parimin e individualizimit të masave por më ka lënë përgjegjëse për një shkelje të cilën nuk e kam bërë. Komisioni Disiplinor gabimisht ka konstatuar se kinse mos zbatimi i urdhrin të mbikëqyrësi konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore ngase kjo nuk është e parapara me nenin 56 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse vetë mbikëqyrësi nuk ka sqaruar se çfarë deklarate të jap në këtë rast ankuesja. Masa disiplinore është shqiptuar pa asnjë provë materiale dhe si e tillë është e paligjshme. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 29 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet: *1. Zyrtarja/i publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me urdhrin e marrë nga mbikëqyrësja/i apo zyrtarja/i tjetër me kompetenca kontrolli ndaj saj/tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të institucionit. 2. Në rastet kur zyrtarja/i publik dyshon për paligjshmërinë e urdhrin të mbikëqyrësit, ajo/ai nuk e zbaton urdhrin, por informon menjëherë mbikëqyrësen/in e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e mbikëqyrëses/it të personit që ka dhënë urdhrin. 3. Zyrtarja/i publik është i detyruar të zbatojë urdhrin e konfirmuar me shkrim, sipas paragrafit 2. të këtij neni, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.*
- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: “Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërmbyllja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbyllje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbylljen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbylljen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; **4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil**; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

- Neni 57 paragrafi 2: “Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; **2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite**; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.

Duke u bazuar në përcaktimin ligjor si më sipër, Kolegji ka analizuar aktin e kontestuar në ndërlidhje me provat materiale dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Vushtrisë më rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar ka vepruar në kundërshtim me ligin material, mbi arsyet se kërkesa e datës 24.10.2026, e parashtruar nga Udhëheqësi i Sektorit të Gjendjes Civile në cilësi të mbikëqyrësit të ankuesit ka të bëjë me shkelje të detyrave të punës për shkak mos zbatimit të urdhrin të eprorit, ndërsa, Komisioni Disiplinor ka tejkaluar kërkesën për inicim të procedurës ashtu që trajton përgjegjësinë disiplinore të ankueses lidhur edhe me sjelljet e ankueses përkitazi me ngjarjen e ndodhur më datë 20.10.2025 mes ankues dhe palës /qytetares, duke e shpallur të njëjtën përgjegjëse për shkelje disiplinore “sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil”.

Rrjedhimisht, në thëniet në ankesë si dhe në deklaratën e datës 13.11.2025, ankuesja ka deklaruar se:... më datën e caktuar (20.10.2025) kam qenë në vendim time të punës ka ardh pala u drejtua të unë , si zakonisht kam kërkuar letërnjoftimin nga pala, ka thënë nuk ka letër njoftimin, i thash në rregull një

dokument me foto, dhe pala ma paraqit një dokumente të vjetër(i paraluftës) ku në atë dokument ka qenë emri i fshirë dhe i shkruar më kimik. Në atë moment kam qenë e qetë dhe jam drejtuar nga pala se më kate dokument nuk mund të marrësh shërbim, Pala u shpreh më këto fjali” ju i tuboni kurvat e komunës, ju jeni kurvat e komunës, edhe ti je qashtu, shitni më parë”, unë u shkova dhe u largova dy here nga vendi im i punës, pala serish ka vazhdua me fol dhe ku jam kthyer kish qene shume e acarume , i kam thenë kolegëve thirrne sigurimin,.. nuk jam kam thënë asnjë fjalë palës, ajo vazhduar ofendimet me ton të lartë.... Jam kthyer te shkoj në zyrën e shefi time, por ai s’kishte qene ne zyrë, e as drejtoresha dhe jam dal vet me kqyr për sigurim, pala ka vazhdu me ofendime dhe jam dal te ajo dhe i kam thënë “zojë cka ke më mu” edhe koleget e mijë kanë ardh pas meje për sigurim, mbasandaj Xh. e ka thirr sigurimin dhe une jam kthyer brenda e shokuar...pasi ka përfunduar gjithçka ka ardh mbikëqyrësi dhe ka marre informacion nga kolget cka ka ndodhë, kamë dhënë deklaratë para L. dhe jam sqaruar cka ka ndodhe dhe si dëshmitare ka qenë A.M.... Kemi qenë në bufe bashkë më F.K., A. dhe L.K. dhe kemi diskutuar zyrtarisht për këtë çështje dhe e kemi marr te mbyllur këtë çështje nga mbikëqyrësi L.K. Dmth ankesë nuk ka pas prej palës dhe kjo çështje është mbyllë si procedurë. Te nesërmen... mbikëqyrësi më ka thirr në zyrë dhe me ka thënë së duhet më jep deklaratë rreth rastit , une i thash pse a s’ka përfundua ky rast a, ti the mbase s’ka ankesë prej palës, na vec e përfundum këtë punë dhe ka qenë fundi i orarit..... pse kur ka ardh në punë shefi jem nuk e ka diskutua këtë punë se nëse nuk jep deklaratë do të iniciohet prokurë. ...Unë e kam marr si punë të kryme dhe vetëm pas 10 ditësh më ka ardh njoftimit se ndaj meje është iniciuar procedurë disiplinore... nuk ka dhënë deklaratë më shkrim sepse kam dhënë deklaratë më gojë pranë udhëheqësit dhe dëshmitareve dhe me kanë thënë që ka përfundua si procedurë...|

Ndërsa, zyrtarët F.A, Xh.M, A.T, Sh.U dhe V.M-Z, që të gjithë zyrtarë prezent në ditën e ngjarjes, kanë deklaruar pranë Komisionit Disiplinor se në ditën kritike pala ka ardh në sportel tek ankuesja, pasi kjo nuk i ka kryer shërbimin për shkak së pala s’ka poseduar dokumentacion valid të identifikimit, atëherë, pala ka përdor fjalor shumë ofenduese ndaj ankuseses. Shtojnë së ankuesja ka pas sjellje korrekte në raport me palën, e duke qenë së askush nuk e ka ftuar sigurimin, ankuesja ka dal vet nga sporteli në mënyrë ta thrras sigurimin, por duke qenë së pala edhe gjatë kohës sa ka dal ankuesja ka vazhduar me fyerje, atëherë, ankuesja i është ofruar palës pse është duke e ofenduar dhe fyer, dhe së asnjëri nga dëshmitarët nuk ka konfirmuar së në mes të palës dhe ankues ka pas sulm apo kontakt fizik.

Rrjedhimisht, bazuar në video incizimin (pa zë) e sigurua si provë nga Komuna e Vushtrrisë, Kolegji nga ana vizuale ka arrit të vërtetoj faktin së pala gjatë kohës sa kërkonte shërbim kishte veprime të vazhdueshme trupore me duar, ankuesja ndërkohë del nga sporteli dhe i afrohet palës ku kishte ngritje të duarve nga të dy palët, po nuk vërehet përleshje apo goditje fizik, andaj, mbi këto rrethana, e duke marrë parasysh edhe deklaratimet e dëshmitareve të lart theksuar, dhe meqenëse ankuesja nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore, atëherë në vlerësimin e Kolegjit në veprimet e ankuseses nuk manifestohet elemente të shkeljes së rëndë disiplinore, por, sipas Kolegjit veprimet e ankuseses duhet të ri vlerësohen nga mbikëqyrësi i saj në kuptim të shkeljes së lehtë disiplinore.

Andaj, nisur nga gjetjet dhe vlerësimet si më lartë, vendosja meritore lidhur me këtë çështje disiplinore nuk është e mundur, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, e duke u bazuar në autorizimet ligjore sipas nenit 53, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme dhe nenit 18 paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji aprovoj ankesën si të bazuar, shfuqizoj Vendimin me numër protokolli 00247/26, të datës

05.01.2026, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Vushtrrisë, duke kthyer çështjen në rishqyrtim tek mbikëqyrësi i ankueses me obligimin që ky i fundit të marrë për bazë pikëpamjet juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi dhe të ndërmerr veprime ndaj ankueses në kuptim të shkeljeve të lehta disiplinore.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.86/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.H-H;
- Komunës e Vushtrrisë: Udhëheqësit të Sektorit të Gjendjes Civile dhe Udhëheqësit të NBNJ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.